



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 7.9.2023

Nr: 766

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT E GRUPEVE TË  
NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË  
DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 95, pika 2, dhe nenit 96, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka të drejtën e propozimit të anëtarit të parë dhe të tretë, të Grupeve të Numërimit të Votave.
2. “Partia e Lirisë” ka të drejtën e propozimit të anëtarit të dytë të Grupeve të Numërimit të Votave.
3. “Partia Demokratike” ka të drejtën e propozimit të anëtarit të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 7.9.2023 Nr: 766  
Ora: 17:00



“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”